

TERMAT DHE KUSHTET PËR PROMOCIONIN NË KOSOVË

"Mblidhni pikë dhe kapeni mundësinë për të fituar dhurata për kuzhinën tuaj"

1. ORGANIZATOR

Programi i besnikërisë së konsumatorit (në tekstin e mëtejme i referuar si "Programi") i titulluar "Mblidhni pikë dhe kapeni mundësinë për të fituar dhurata për kuzhinën tuaj" organizohet nga Coca-Cola HBC Kosova (në tekstin e mëtejme "Organizatori").

2. KOHËZGJATJA DHE VENDNDODHJA E PROGRAMIT

Programi do të zgjasë nga data 24 shkurt 2025 në orën 12:00 deri në mbarimin e stoqeve të dhuratave, por jo më vonë se data 22 prill 2025 ora 12:00. Programi është i vlefshëm brenda territorit të Kosovës në pikat e aktivizuara me promocion.

3. INFORMACION I PROGRAMIT

Këto Terma dhe Kushte, së bashku me detaje shtesë rreth Programit, publikohen në faqen e internetit <https://www.coca-cola.com/xk/sq> dhe në aplikacionin Coca-Cola.

Duke skanuar faturën e tyre të parë në aplikacionin Coca-Cola, pjesëmarrësit konfirmojnë se i kanë lexuar dhe pranuar këto Rregulla dhe Kushte.

Për çdo pyetje në lidhje me programin, pjesëmarrësit mund të kontaktojnë organizatorin përmes emailit në promo.ks@cchellenic.com

4. PRODUKTET PJESËMARRËSE

Produktet e mëposhtme të Coca-Cola (në tekstin e mëtejme të referuara si "Produkte promovionale") përfshihen në Program:

- **Coca-Cola Original Taste (CCOT):** 0.33L, 0.45L, 1.25L, 2L
- **Coca-Cola Zero Sugar (CCZS):** 0.33L, 0.45L, 1.25L, 2L
- **Coca-Cola Cherry:** 0.33L, 1.25L

5. RREGULAT E PJESËMARRJES

Për të marrë pjesë në Program dhe për të fituar pikë, konsumatorët duhet të:

1. **Blejnë një nga Produktet Promovionale** gjatë periudhës së promovionit.
2. **Skanojnë faturën e tyre në aplikacionin Coca-Cola** për të mbledhur pikë.
3. **Shkëmbejnë pikët me dhurata** nga koleksioni i kuzhinës (një maksimum prej **tre dhuratave për pjesëmarrës**).

6. SISTEMI I PIKËVE DHE DHURATAVE

Çdo faturë e skanuar do të gjenerojë pikë bazuar në produktet e blera. Pjesëmarrësit mund të shkëmbejnë pikë për dhuratat e mëposhtme, për aq sa zgjat stoku:

Dhurata	Sasia	Pikët e duhura
Xhezve	1,100	8

Enë Conus	2,500	12
Tenxhere e vogël	2,500	28
Tenxhere	1,500	38
Tavë	1,500	18
Tigan	1,500	30
Doreza gatimi	15,000	6
Dërrasë për prerje	3,750	14
Blender	50	98
Gota me logo të Coca-Cola	20,000	10

7. PROCESI I POROSISË SË DHURATAVE

1. Kur pjesëmarrësit i mbledhin pikët e mjaftueshme, ata mund t'i shkëmbejnë ato për një dhuratën që e dëshirojnë nëpërmjet aplikacionit Coca-Cola.
2. Pasi të konfirmojnë përzgjedhjen e tyre, ata do të marrin një ID unike të dhuratës.
3. Pjesëmarrësit duhet të japin të dhënat e nevojshme personale në formularin e caktuar online, duke përfshirë:
 - o Emrin
 - o Mbiemrin
 - o Numrin e telefonit celular
 - o Adresën e e-mailit
 - o Qytetin
 - o Adresën e banimit
 - o ID-në unike të dhuratës
4. Afati i fundit për dërgimin e formularit të porosisë së dhuratës është data 22.04.2025. Nëse formulari nuk dorëzohet brenda këtij afati kohor, pjesëmarrësit e humbin të drejtën për të kërkuar dhuratën.

8. PROCESI I TËRHEQJES SË DHURATAVE

- Dhuratat do të dërgohen përmes “Posta e Kosovës”.
- Dhuratat do të dërgohen brenda 30 ditëve pas porosisë së dhuratës.
- Nëse fituesi nuk mundet, për ndonjë arsye, të marrë personalisht dhuratën në zyrën postare në kohën kur posta e dorëzon atë, fituesi mund të kontaktojë Shërbimin e Klientit për t’u informuar rreth pikës së tërheqjes.
- Dhuratat do të jenë në dispozicion për tërheqje në lokacionet e caktuara nëpër Kosovë.
- Pjesëmarrësit duhet të paraqesin dokumentin e tyre të identifikimit dhe ID-në e dhuratës në momentin e tërheqjes.
- Afati përfundimtar për tërheqjen e dhuratave është 22.05.2025. Tërheqja e dhuratave pas datës së cekur **nuk është e mundshme**.

9. RREGULLAT DHE KUSHTET E PËRGJITHSHME

- Çdo pjesëmarrës mund të aplikoj për maksimum tre dhurata.
- Pikët e mbledhura në këtë Program nuk mund të barten në promocionet e ardhshme.
- Organizatori rezervon të drejtën të diskualifikojë pjesëmarrësit që shkelin Rregullat dhe Kushtet ose tentojnë pjesëmarrje mashtruese.
- Organizatori nuk mban përgjegjësi për ndonjë vonesë në disponueshmërinë e dhuratave për shkak të rrethanave të paparashikuara.
- Duke marrë pjesë në këtë Program, pjesëmarrësit bien dakord për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave të tyre personale vetëm për qëllimet e promocionit. Të gjitha të dhënat do të fshihen pas përfundimit të programit.

Për detaje dhe përditësime të plota, vizitoni <https://www.coca-cola.com/xk/sq> ose kontaktoni e-mailin: promo.ks@cchellenic.com ose numrin: **038 540 885 10**